



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës

Nr. 997 prot.,

Tiranë, më 27.03.2026

Programi vjetor i aktiviteteve për vitin 2026
Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës

Në mbështetje të Përcaktimeve të Rregullores së Brendshme të Entit Rregullator të Energjisë, e po ashtu në vijim të punëve të realizuara deri më tani gjatë vitit 2025, bazuar në detyrat funksionale të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës, nga ana e Drejtorisë është përgatitur një program vjetor i aktiviteteve të drejtorisë për vitin 2026, si vijon:

- Ndjekja e të gjitha aplikimeve të paraqiten pranë DLAGO për licencim, rinovim, modifikim, transferim, njohje apo heqje licence.
- Ndjekja e të gjitha aplikimeve të paraqiten pranë DLAGO për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve të paluajtshme që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj të tretëve.
- Ndjekja e zbatimit të kushteve të vendimeve të licencimit, përgatitja e korrespondencës dhe praktikës përkatëse në lidhje me rishikimin e vendimeve të licencimit, në kuadër të plotësimit të kushteve nga të licencuarit.
- Ndjekja e të gjitha aplikimeve të paraqiten pranë DLAGO për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse, ndryshimin e statusit ligjor të ortakut që kontrollon interesat e të licencuar, apo për vendosjen e kuotave të të licencuarit si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj të tretëve.
- Ndjekja e të gjitha aplikimeve të paraqiten pranë DLAGO për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit në rastin e subjekteve të licencuar në prodhimin e energjisë elektrike.
- Ndjekja e procedurave përkatëse për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e Garancive të Origjinës.
- Përgatitja e praktikave për rishikime të vendimeve për dhënien e autorizimeve, sipas rastit, për shkak të plotësimit/mosplotësimit të kushteve respektive.

- Përgatitja e informacioneve për Bordin sipas rastit dhe vlerësimit të praktikave të mundshme.
- Pjesëmarrje në Mbledhjet konsultative e gjithashtu në mbledhjet e Bordit që do të zhvillohen përgjatë vitit 2026.
- Ndjekja e të gjitha korrespondencave që paraqiten për trajtim pranë Drejtorisë, apo bashkëpunimi me Drejtoritë e tjera sipas nevojave të punës. Zbatimi i të gjitha detyrave të ngarkuara për ndjekje rast pas rasti.
- Përgatitja e licencave përkatëse pas çdo vendimmarrje të Bordit për licencim, rinovim modifikim apo transferim.
- Përditësimi i Regjistrit të Licencimeve pas çdo vendimmarrjeje të Bordit, si dhe databasa përkatëse për procedura në proces dhe statusin e tyre, dhe publikimi i tyre në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Përditësimi i Regjistrit të Autorizimeve pas çdo vendimmarrjeje të Bordit, si dhe databasa përkatëse për procedura në proces dhe statusin e tyre, dhe publikimi i tyre në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Ndjekja e seancave dëgjimore që mund të organizohen/planifikohen gjatë vitit për çështje që i ngarkohen DLAGO për ndjekje.
- Ndjekja e workshop-eve, aktiviteteve apo trajnimeve, sipas rastit, përgjatë vitit 2026, brenda apo jashtë vendit.

Përveç trajtimeve rast pas rasti, si më sipër referuar, DLAGO do të ndjekë procedurat e finalizimit të praktikave të nisura gjatë vitit 2025 si vijon:

- Ndjekja/finalizimi i praktikave për aplikimet e paraqitura nga shoqëritë për licencim në veprimtarinë e prodhimit/tregtimit/furnizimit të energjisë elektrike, sipas afteteve respektive ndjekur me regjistrin e aplikimeve.
- Ndjekja/finalizimi i praktikave për aplikimet e paraqitura nga shoqëritë për rinovimin e licencave përkatëse.
- Ndjekja/finalizimi i praktikës për aplikimin e paraqitur për modifikimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, sipas afateve respektive ndjekur me regjistrin e aplikimeve.
- Ndjekja/finalizimi i praktikave në lidhje me dhënien e autorizimit nga ERE për barrësimin e kuotave përkatësisht, sipas afateve respektive ndjekur me regjistrin e aplikimeve.
- Ndjekja/finalizimi i praktikave në lidhje me dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të të licencuarit, sipas afateve respektive ndjekur me regjistrin e aplikimeve

- Ndjekja/finalizimi i praktikës në lidhje me dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve nga shoqëritë sipas afateve respektive ndjekur me regjistrin e aplikimeve.
- Finalizimi i procedurës për rishikimin e Rregullores së licencimit.

Përveç finalizimit të disa praktikave të nisura që në vitin 2025, si më sipër referuar, DLAGO parashikon të ndjekë dhe sa vijon:

- Ndjekja e procedurave, rast pas rasti, për rishikimin e akteve nënligjore ekzistuese, apo rishikime të akteve apo përpilime të akteve të reja, studimeve, etj në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në ERE, e konkretisht:
- Fillimi dhe ndjekja e praktikave për rishikimin e rregulloreve në lidhje me autorizimet, përkatësisht në lidhje me “Rregulloren e procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit miratuar me vendimin nr. 119, date 21.07.2016 të bordit të ERE-s” dhe “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ere për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin nr. 235, datë 26.11.2021 të bordit të ERE-s”

Rakorduan: F. Mezini

A. Meziu

Miratoi: O. Kallaku

Drejtor

Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve

E. B. Radheshi

Sekretar i Përgjithshëm

Nr. i kopjeve: 3 (tri)